



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:026558

Datë: 03.03.2021

Numri i dokumentit: 01560284

P.nr.625/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit V.M. nga fshati B., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1005/2017, të datës 20.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 15.02.2021, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 03.03.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri V.M., nga babai R. dhe nëna I., e lindur V., i lindur me datë ... në Gjilan, ndërsa me vendbanim në fshatin B., Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa pune, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë ..., rreth orës 16:00h, në rrugën e ... më saktësisht tek tregu i gjelbër në Gjilan, i pandehuri V.M., me dashje me veprimet e tij të kundërligjshme, duke drejtuar veturën e tij të markës “Mercedes” me targa ....., në mënyrë të pa kontrolluar, duke sjellë në mënyrë shumë të shpejtë dhe të vrullshme në parkingun e tregut të gjelbër ku si pasojë nga rrotat e veturës kërcëjnë gurtë zhavorrit të parkingut dhe me këtë rast na gurët, dëmtohen në mënyrë sipërfaqësore tri vetura njëra e tipit “Passat” me targa ..... pronë e A.B. nga Gjilani, veturë e tipit “Golf 4”, me targa .... pronë e I.B. nga fshati Vërbicë e Zhegovcit, vetura e tipit “Opel Corsa” me targa ....., pronë e A.M., të cilat kanë qenë të parkuara aty, e pas kësaj i pandehuri nuk ndalet fare dhe vazhdon në drejtim të pa njohur dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija, të dëmtuarve iu shkakton dëm materiale në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,41,42,49,50,51,52,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin V.M.:

## E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit A.B., I.B. dhe A.M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë) euro si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 20.06.2017, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1005/2017, kundër të pandehurit V.M. nga fshati B., Komuna e Gjiilanit, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Me datë 15.02.2021, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri, me ç'rast pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e kishte kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës lëndore andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti i oficerit i datës 14.06.2017, deklarata e të pandehurit, kopja e patente shoferit dhe librezës, akti përcjellës, raporti fillestarë i incidentit me numër 2017-CA-0875 i datës 09.06.2017, hartuar nga njësia e hetimeve të Stacionit të policisë në Gjiilan, deklarata e të dëmtuarve, raporti i oficerit i datës 09.06.2017, deklarata e të pandehurit, deklaratat e të dëmtuarve, deklarata e dëshmitarit, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri V.M. ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit si dhe faktin se për të njëjtin është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 74 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime duke faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, është i gjendjes së varfër ekonomike, i pa punësuar, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 3 vite burgim (neni 47 i KPP-ës) vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale gjithashtu duke u bazuar në të lartëcekurat dhe në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 76 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit A.B., I.B. dhe A.M., i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) si shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.625/2017, me datë 03.03.2021

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.